



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Kancelaria Premijera - The Prime Minister Office

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Zyra e Kryeministrit të Kosovës shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar i lartë ligjor për legjislacion të BE-së
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 1
<b>Koeficienti/Paga</b>	8
<b>Nr. i kërkuar</b>	2
<b>Data e njoftimit</b>	29/08/2022
<b>Afati për aplikim</b>	13/09/2022 - 20/09/2022
<b>Institucioni</b>	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
<b>Departamenti</b>	Departamenti i Drejtës së BE-së
<b>Divizioni</b>	Divizioni i Çështjeve Ligjore të BE-së
<b>Vendi i punës</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00009806
<b>Kodi</b>	RPC0003531



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

Detyra 1: Ndjek zhvillimin e politikave dhe legjislacionit të BE-së në fushën përkatëse të Acquis të BE në fushën e tregut të brendshëm, në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, në fushat e lidhura me tregti, konkurrencën, mbrojtjen e shëndetit dhe konsumatorëve, bujqësinë, peshkatarinë, mjedisin, pylltarinë, dhe sigurinë e ushqimit. 30%

Detyra 2: Koordinon dhe lehtëson procesin të përafrimit të legjislacionit me Acquis të BE-së me ministritë përkatëse dhe me organet tjera administrative shtetërore për fushat përkatëse që mbuloohen prej tyre. 10%

Detyra 3: Përpilon dhe lëshon opinionin ligjor për përputhshmërinë me Acquis të BE-së, dhe ofron ndihmë profesionale në procesin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me Acquis të BE. 20%

Detyra 4: Merr pjesë në përgatitjen dhe monitorimin e implementimit të dokumenteve strategjike të rëndësishme të Qeverisë në lidhje me procesin e Integritimit Evropian. 5%

Detyra 5: Bashkëpunon me departamentet tjera brenda ministrisë në çështjet që lidhen me procesin e integritimit Evropian dhe përafrimin e legjislacionit. 10%

Detyra 6: Bashkëpunon me organet tjera administrative shtetërore në çështjet që lidhen me procesin e integritimit Evropian dhe përafrimin e legjislacionit. 5%

Detyra 7: I raporton Udhëheqësit të Divizionit të Çështjeve Ligjore të BE-së. 10%

Detyra 8: Kryen edhe punë tjera të caktuara nga Udhëheqësi i Divizionit dhe Drejtori i Departamentit, e që janë brenda fushe-veprimtarisë së divizionit dhe Departamentit për të Drejtën e BE-së. 10%

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

Diplomë/a universitare në Fakultetin Juridik me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor).

Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;

### 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën profesionale dhe aspektet përkatëse të kërkesave të integritit evropian;

Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;

Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Njohja e gjuhës angleze është obligative;

Të jetë energjik dhe në gjendje të punojë me orar fleksibil dhe tryzni kohe , të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë pune .

### 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

### 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 27/09/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

### 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- 04/10/2022, Ndërtesa e Qeverisë, Zyra e Kryeministrit , Prishtinë



## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën profesionale dhe aspektet përkatëse të kërkesave të integritetit evropian;

Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;

Njohja e gjuhës angleze

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Nuk ka

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

